



**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAM ORIENTUES  
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR  
TË MATURËS SHTETËRORE**

**LËNDA:**

**GJUHË GJERMANE**

**Koordinatore: Erifili Hashorva**

**VITI MËSIMOR 2011 – 2012**

# **1. UDHËZUES I PËRGJITHSHËM PËR PROGRAMIN E PROVIMIT KOMBËTAR TË MATURËS SHTETËRORE PËR LËNDËN E GJERMANISHTES DHE PËR PËRDORIMIN E TIJ NGA MËSUESIT**

Programi orientues i provimit kombëtar të Maturës Shtetërore për gjuhën gjermane përmban në mënyrë të përmbledhur sasinë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë në tre vitet e gjimnazit në aspektin tematik dhe në aspektin gjuhësor e funksional. Mësimi i gjuhës gjermane ndihmon në mënyrë të veçantë formimin e përgjithshëm të nxënësit, duke mundësuar pajisjen e tij me një mjet shprehës më tepër, me teknikat dhe metodologjinë e përshtatshme komunikative që do t'i shërbejnë atij për t'u bërë pjesë e shkëmbimeve të shumëllojshme në situata të larmishme jetësore, si dhe me një mjet më shumë për të njohur botën dhe për të pasuruar dijet.

Për hartimin e këtij programi orientues u morën parasysh korniza kurrikulare e gjuhëve të huaja, standardet e gjuhës së huaj në arsimin parauniversitar, programet e tre viteve të gjimnazit, si edhe tekstet me të cilat zhvillohet mësimi i gjuhës gjermane në gjimnaz.

Programi orientues për përgatitjen e Maturës Shtetërore të gjuhës gjermane përmban në mënyrë të përmbledhur sasinë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë në tre vitet e gjimnazit në aspektin tematik dhe në aspektin gjuhësor funksional.

## **Synimet e programit**

Me anë të këtij programi orientues synohet:

- Të ndihmohet maturanti në përgatitjen e provimit të gjuhës gjermane.
- Të ndihmohet mësuesi për të dhënë orientimet e duhura për punën përgatitore me nxënësit.
- Të bëhet vlerësimi i njëkohshëm i dy aftësive bazë, të cilat përbëjnë dy konceptet bazë të aftësisë së komunikimit, që janë: të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim.
- Të japë orientime për hartuesit e testeve të provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën gjermane.

*Vlerësimi i aftësisë gjuhësore e komunikative nënkupton:*

- vlerësimin e të kuptuarit dhe të shprehurit me anë të strukturave gjuhësore bazë,
- në aspektin e tyre fonetik, morfologjik, sintaksor, leksikor, funksional,
- aftësinë për të përdorur kodin gjuhësor në mënyrë të pavarur dhe të përshtatshme me situatat e komunikimit.

## **Udhëzime praktike për përdorimin e programit**

- Specifika e gjuhës së huaj duhet të kihet parasysh nga mësuesit gjatë përdorimit të këtij programi. Nxënësi në provim do të përballet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi, por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato.
- Pjesë e testit do të jetë gramatika. Këtu mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi një problem të caktuar gramatikor (Prwpositionen, Passiv, Perfekt, Prwteritum, Modalverben, Konjunktiv II, u.s.w.), duke dalë nga tipi i ushtrimeve tradicionale që jepen nëpër tekste dhe duke praktikuar formate të reja ushtrimesh ku të përfshihen këto aspekte gramatikore, duke e parapërgatitur nxënësin për ato që do trajtohen në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore. Mësuesi duhet të fokusohet në anën praktike të zgjidhjes së ushtrimeve.
- Funksionet gjuhësore të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme, duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës, por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Në to duhet të ndihet rëndësia dhe ndikimi i madh që ka të mësuarit dhe të folurit e gjuhës gjermane.
- Në pjesën e të shkruarit mësuesi të ushtrojë nxënësit e tij që ata të dinë të organizojnë fjalët në fjali, fjalitë në paragrafë dhe paragrafët në një ese. Gjithashtu, mësuesi të përgatisë nxënësit që ata të përmbledhin me shkrim një përvojë personale, duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tyre në një tekst koherent.

## **2. AFTËSITË DHE NJOHURITË QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI MATURENT PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURES NË GJUHËN GJERMANE**

Në provimin e Maturës Shtetërore, nxënësit do të vlerësohen për dy aftësitë gjuhësore.

### **2.1 Të kuptuarit me shkrim –Leseverstehen**

Boshti i kësaj pjese do të jetë një tekst i panjohur mbi të cilën do të ndërtohen ushtrime kuptimore.

Këtu është shumë e domosdoshme që nxënësi të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë globale tekste për të gjetur informacionin e kërkuar; për të mbledhur informacionet që i kërkojnë nga pjesë të ndryshme të një teksti, apo tekste të ndryshme për të përmbushur një detyrë të caktuar.

Në një pjesë leximi, nxënësi të dallojë faktin nga opinioni, duke përdorur informacion të saktë, argumente dhe pikëpamje që të jenë koherente.

Dallimi i informacionit thelbësor nga ai i parëndësishëm, duke vendosur kritere për gjykim, analizë dhe nxjerrje konkluzionesh rreth një çështjeje të caktuar, janë çështjeje për të cilat nxënësi duhet të jetë i parapërgatitur.

*Aftësia e të kuptuarit me shkrim përfshin:*

- kuptimin global të tekstit,
- kuptimin selektiv: gjetjen e informacioneve specifike,
- përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit,
- kuptimin e thelluar: gjetjen e të pashprehurës ose të nënkuptuarës, qëndrimin e autorit etj.
- plotësimin e ushtrimeve leksikore rreth tekstit,
- kryerjen e ushtrimeve gramatikore rreth tekstit,
- gjetjen e fjalëve referuese (p.sh., kujt i referohet ky përemër në fjali),
- formimin e një kuptimi të përgjithshëm,
- marrjen dhe përzgjedhjen e informacionit të duhur brenda një teksti të caktuar,
- reflektimin mbi përmbajtjen e një teksti dhe vlerësimin se sa me vend janë disa elemente të informacionit,
- zhvillimin e aftësisë interpretuese, duke bërë një përfundim logjik,
- gjetjen e një informacioni sinonim,
- zhvillimin e aftësisë interpretuese, duke bërë identifikimin dhe paraqitjen e elementeve provuese,
- reflektimin mbi përmbajtjen e një teksti, duke u bazuar mbi disa vlera dhe bindje për të dhënë një gjykim në lidhje me moralin e një historie.

## **2.2 Të shprehurit me shkrim**

Këtu nxënësi duhet të paraqesë një produkt të shkruar prej **120-150** fjalësh, ku të zhvillojë një temë për një çështje me interes të përgjithshëm, duke marrë shkas nga pjesa e panjohur ose jashtë saj.

*Aftësia e të shprehurit me shkrim përfshin:*

- një gamë të gjerë temash të njohura e komplekse, për të cilat është folur gjatë mësimëve,
- një produkt të shkruar saktë nga ana gramatikore dhe të strukturuar mirë (letër formale ose joformale, paragraf përshkrues),
- lidhjen në mënyrë logjike të informacioneve nga burime të ndryshme,
- shprehjen e pikëpamjeve të tij në formë të argumentuar,

- përdorimin e një fjalori të gjerë,
- paraqitjen me shkrim të problemeve të ndryshme që i kërkohen.

Gjatë të shprehurit me shkrim, kërkohet që nxënësi:

- të dijë të organizojë mirë përmbajtjen e punës me shkrim, duke qenë gjithnjë në koherencë me temën e dhënë.
- të vendosë dhe të ruajë një këndvështrim të vetin dhe origjinal për temën mbi të cilën do të shkruajë.
- të shkruajë paragrafë të plotë, në të cilët të ketë detaje dhe informacione specifike për temën e dhënë.
- të ruajë rendin e mendimeve në të gjithë pjesën e shkruar.
- të përdorë tipe dhe gjatësi të ndryshme fjalish.

## **Njohuritë**

Gjatë tre viteve të gjimnazit, nxënësit kanë trajtuar tema të ndryshme, që në këtë program jepen përmes fushave tematike të mëposhtme, të cilat janë ndarë në fusha dhe nënfusha sipas tematikës së zhvilluar në gjimnaz dhe elementeve gramatikore, të cilat zhvillohen gjatë tre viteve të gjimnazit të detajuara në program.

## **Shprehitë**

Një element i rëndësishëm i gjuhës janë shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar gjatë tre viteve të gjimnazit, të cilat jepen përmes akteve dhe funksioneve komunikative. Njëpërmjet shembujve, ata tregojnë se cilat janë shprehitë kryesore që një nxënës ka fituar përmes realizimit të programit të gjimnazit dhe aftësinë e tij për t'i përdorur në situata të ndryshme.

## **Tipet e ushtrimeve për çdo fushë**

<b>Të kuptuarit me shkrim (Leseverstehen)</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- pyetje mbi përmbajtjen e tekstit,</li> <li>- ushtrime me vende bosh,</li> <li>- ushtrime me përgjigje po/jo,</li> <li>- ushtrime të tipit e vërtetë /e rreme,</li> <li>- ushtrime me disa alternative,</li> <li>- renditja e paragrafëve të ngatërruar sipas logjikës dhe rrjedhës logjike,</li> <li>- gjetja e një informacioni në një tekst,</li> </ul>

- gjetja e një informacioni nga tekste të ndryshme.
<b>Leksiku dhe gramatika (Wortschatz und grammatik)</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- ushtrime me zëvendësim,</li> <li>- ushtrime transformimi,</li> <li>- ushtrime me alternativë,</li> <li>- ushtrime me plotësime vendesh bosh,</li> <li>- ushtrime ndërtim fjalish,</li> <li>- ushtrime bashkim fjalësh me kuptimin, gjetje gabimesh,</li> <li>- bashkim funksioni me strukturën përkatëse,</li> <li>- gjetja e sinonimeve dhe e antonimeve,</li> <li>- shprehja e të njëjtit kuptim me fjalë të tjera.</li> </ul>
<b>Të shkruarit (Schriftlicher ausdruck)</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të shprehurit në formë dialogu,</li> <li>- formulim pyetje / përgjigje,</li> <li>- plotësim frazash,</li> <li>- letër formale dhe joformale, mesazh, e- mail, kartolina, ftesa, njoftime, aplikime,</li> <li>- radhitje paragrafësh sipas lidhjes logjike,</li> <li>- hartim me pika referimi,</li> <li>- përmbledhje, koment,</li> <li>- ese e shkurtër,</li> <li>- plotësim i një formulari.</li> </ul>

### Ndarja e peshës sipas fushave

<b>FUSHAT</b>	<b>Përqindja</b>
<b>Të kuptuarit me shkrim (Leseverstehen)</b>	<b>40%</b>
<b>Leksiku dhe gramatika (Wortschatz und grammatik)</b>	<b>40%</b>
<b>Të shprehurit me shkrim (Schriftlicher ausdruck)</b>	<b>20%</b>

### **3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

#### **Fushat tematike dhe leksiku**

Përmbajtja tematike është mbështetur në programin e zhvilluar gjatë tre viteve të gjimnazit, si edhe në tekstet shkollore për gjuhën gjermane. Tematika e mëposhtme, e parashikuar për provimin e Maturës, do të përfshijë temat bazë (sipas kurrikulës) dhe nëntema të marra nga kurrikula dhe tekstet.

Temat janë formuluar në mënyrë përgjithësuese e jo sipas titujve të teksteve dhe përfshijnë ato njohuri, të cilat janë zhvilluar përmes mësimëve.

#### **Erlebnisbereich ‘Ich als Person‘**

- Persönliche Daten, Lebenslauf
- Aussehen und Geschmack,
- Gesundheit, Krankheit
- Kleidung
- Tagesablauf,
- Hobbys und Freizeit.

#### **Erlebnisbereich ‘Unmittelbare Umgebung‘**

- Familie, Freunde und Bekannte, Nachbarn
- ‘Familie’ definieren/ Familienaufgaben
- Eine kleine oder eine grosse Familie haben?- Rollenverteilung
- Familienfeste und Geschenke, Essen und trinken
- Wohnung, Umzug und Einrichtung
- Jugend und ihre Probleme /Jugend ‘ definieren
- Sport und Fitness
- Die Liebe hat keine Grenze- Liebeskummer
- Träume und Wünsche definieren
- Auf dem Land /in der Stadt.

#### **Erlebnisbereich ‘Weitere Umgebung‘**

- Fremd(e)
- Reise – Impressionen / Reisepläne
- Urlaub
- Heimat: Was ist Heimat? Einen Begriff umschreiben
- Kommunikation

- Lebensstationen
- Schule und Schulerfahrungen
- Ausbildung und Berufswege
- Arbeitswelt und Karriere
- Warenwelt.

### **Vermittelte Erlebnisbereich**

- Massenmedien:
- Nachrichten und Berichte
- Medien und Werbung – Mit Medien durch den Tag
- Sprachunterricht mit/ohne Medien
- Landeskunde und interkulturelles Lernen:
- Das eigene Land
- Deutschsprachige Länder
- Aus der Politik und Geschichte.

### **Funktionet kommunikative**

Propozohen aktet dhe funksionet e mëposhtme:

- Eigene Meinungen äussern: meiner Meinung nach...; Ich bin mir sicher dass...; Ich würde sagen ...; usw.
- Vermutungen, Behauptungen formulieren: Ich behaupte...; Ich vermute...; Ich glaube...; Kann sein dass...; Wahrscheinlich...; usw.
- Sich pro und kontra äussern: Ich stimme zu; Ich bin dafür; Ich bin völlig dagegen. usw.
- Über eigene Erfahrungen berichten. Über Ereignisse in der Vergangenheit berichten.
- Etwas Irreales ausdrücken.
- Ratschläge geben., um Rat bitten.
- Gefallen, Missfallen ausdrücken.
- Gefühle ausdrücken, Wünsche äussern, Glückwünsche aussprechen.
- Informieren und nachfragen.
- Etwas begründen, etwas beurteilen, etwas bewerten, vergleichen, Verständnis zeigen, erstaunt oder kritisch reagieren.



## Elementet dhe strukturat gramatikore

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore sugjerohen strukturat dhe çështjet gramatikore të mëposhtme:

- Verb: Präsens
- Perfekt, Präteritum
- Futur 1, Plusquamperfekt
- Passiv
- Konjunktiv II
- Regelmässige, Unregelmässige Verben
- Trennbare Verben
- Modalverben
- Partizip I und II
- Unbestimmter, bestimmter Artikel, Negativartikel, Frageartikel
- Substantiv: Singular, Plural
- Deklination des Substantivs
- Adjektiv: Adjektivideklination und Graduierung
- Prädikativ, Attributives Adjektiv
- Verb und Ergänzungen, Akkusativ- und Dativergänzung: Stellung im Satz
- Infinitiv mit zu..
- Präpositionen mit Akkusativ, Dativ, Genitiv, Wechselpräpositionen
- Präpositionaladverbien
- Verben mit Reflexivpronomen
- Possessivartikel
- Demonstrativartikel: dieser, dieses, diese
- Indefinitpronomen
- Nebensätze:/ Kausalsätze
- Temporale Nebensätze
- Konsekutivsätze/ Finalsätze/ Konzessivsätze
- Relativsatz/ Relativpronomen
- Konditionalsatz
- Temporal-Kausal-Modal-Lokalangaben
- Verben mit Präpositional-Ergänzungen
- Funktionsverb-Gefüge
- Wortbildung: Substantive aus Verben
- Imperativ
- Konjunktionen
- Direktionaladverbien
- Ordinalzahlen.